



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:028973
Datë: 17.09.2024
Numri i dokumentit: 06176137

Ac.nr.7080/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci-kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.M., nga Gjilani, të cilin e përfaqëson me autorizim L.B., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson B.M., zyrtar ligjor tek e paditura, me objekt të kontestit kompensimin i shpërblimit jubilar dhe kompensim i ushqimit gjatë punës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.216/2021 të datës 09.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 17.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.216/2021 i datës 09.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, aktgjykimin e atakuar C.nr.216/2021 të datës 09.09.2022, ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit S.M. nga Gjilani dhe ka detyruar të paditurën- Komuna e Gjilanit, Drejtoria e Arsimit që paditësit t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune në vlerë të 50% të një page bazë shumë e të hollave prej 218 €, në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri më datën 18.04.2020, shumë e të hollave prej 610€ (për 305 ditë pune), respektivisht shumë e përgjithshme prej 828€, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes të padisë (11.02.2021) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës shumë prej 259 euro të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën e të paditurës ta aprovoj si të bazuar kurse aktgjykimin C.nr.216/2021 të datës 09.09.2022, ta prish duke e refuzuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë apo të njëjtin ta prish dhe çështja të kthehet rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 11.02.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurës, të cilën e ka precizuar në seancën e datës 07.09.2022, për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe kompensimin e ushqimit gjatë punës (shujtave), duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.216/2021 të datës 09.09.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura si sekretar i shkollës, sikur që nuk kanë qenë kontestuese pothuajse të gjitha provat e prezantuara nga paditësi andaj edhe i njëjti e ka bërë të besueshme dhe të themeltë kërkesëpadinë e tij. Tutje, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se baza juridike e padisë ka rezultuar të jetë e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, me anë të së cilës në mes tjerash punëdhënësi, sipas nenit 35 par.7 dhe par.8 të Kontratës, obligohet që punëmarrësve tu sigurojë shpenzimet e ushqimit dhe pagën jubilarë, për këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditësit t'i kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë,

për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që nuk ishte kontestuese fakti së paditësi është i punësuar tek e paditura, përkatësisht në Shkollën e Mesme të Lartë Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti”, në Gjilan, në pozitën sekretar i shkollës, ndërsa i njëjti ka 10 vite përvojë pune tek e paditura, dhe në bazë të vërtetimit për ditët e pranisë në punë të datës 22.12.2020, rezulton së paditësi për përudhen kohore nga data 01.01.2019, deri me datë 18.04.2020, siç e ka precizuar kërkesën ka 305 ditë të pranisë në punë, të cilin fakt nuk e ka kontestuar as e paditura.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se duke u bazuar në nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Ndërsa në bazë të nenit 35 paragrafi 8, pika 8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë së *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë”*. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar del se paditësi ka realizuar ditët e punës siç janë të theksua më lart, gjë që është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuara nga Gjimnazi Natyror “Xhavit Ahmeti”, në Gjilan, dhe po ashtu sipas vërtetimit për përvojën e punës të datës 28.02.2020, rezulton së paditësi ka 10 vite përvojë pune, andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke ia njohur shumat përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë dhe për shpërblim jubilar në lartësi prej 50 % të një page bazë, andaj edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit të së paditurës së paditësi është mbështetur gabimisht në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës, pasi që kjo kontratë nuk prodhon efekt për shërbyesit civil, Gjykata e Apelit, gjeti së ky pretendim është i pabazuar. Kjo pasi që bazë të nenit 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe

SBASHK, është paraparë së “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASH-ut”. Kurse sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet së “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Duke qenë së e paditura në këtë rast është punëdhënëse e paditësit, Gjykata e Apelit vlerëson së e njëjta ka për obligim që t’ia bëjë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe pagesën e shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës.

Sa i përket pretendimit së gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vendosur lidhur me këtë lëndë pasi që nuk ka kompetencë lëndore sepse e kompetencës lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, kjo gjykatë vlerëson së ky pretendim nuk qëndron. Kjo pasi që duke marrë për bazë nenin 2 par.1, 2 dhe 4 të Ligjit për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.8/2019, 11 mars 2019) me hyrjen në fuqi të secilit ishte shfuqizuar Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës, rezulton së sekretaret e shkollave fillore dhe të mesme janë nëpunës të shërbimit publik. Lidhur me ligjin e aplikueshëm, statusin e zyrtarëve publik të drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe sekretarëve të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe për kompetencën lëndore të gjykatave për zgjidhjen e kontesteve nga marrëdhënia e punës, ka dhënë Mendim Juridik Gjykata Supreme të Kosovës, Nr.42/2023, të datës 27.02.2023. Sipas këtij mendimi në kontestet nga marrëdhënia e punës për drejtorët, zëvendës drejtorët si dhe sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme që kanë lindur pas datës 09 korrik 2020, zbatohen dispozitat Ligjit për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.8/ 11 mars 2019, Prishtinë), si dhe Ligjit të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, viti V/nr.90, datë 01.12.2010), dhe në kontestet e marrëdhënies së punës për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publik, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, përveç nëse shprehimisht përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë dhe gjykohen sipas rregullave të procedurës kontestimore. Kjo për arsye së këto kategori të nëpunësve nuk e kanë statusin e nëpunësve civil por të njëjtit në bazë të Ligjit për Zyrtar Publik, emërtohen me status të ri nëpunës i shërbimit publik, dhe marrëdhënia e punësimit për këto kategori rregullohet me Ligjin për Zyrtar Publik, dhe së për çështje tjera ky ligj i referon në Ligjin e Punës, dhe së për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga marrëdhënia e punës për këto kategori të nëpunësve të shërbimit publik kompetencë për të vendosur janë Gjykatat-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil.

Lidhur me pretendimin së kërkesa e paditësit është parashkruar pasi që padia është paraqitur pas 3 viteve, Gjykata e Apelit gjeti së ky pretendim nuk qëndron, pasi që paditësi kompensimin e ushqimit në punë (shujtave) e ka kërkuar për periudhën 01.01.2019, deri me datë 18.04.2020, dhe 10 vite të përvojës së punës i ka arritur në vitin 2020, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë me datë 11.02.2021, çka rezulton se kërkesa e paditësit është brenda periudhës sa ka qenë në fuqi kontrata dhe në këtë rast nuk ka kaluar afati prej 3 viteve në mënyrë që të konsiderohet së kërkesa e paditësit është parashkruar ashtu siç përcaktohet me nenin 87 të Ligjit të Punës.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 të LMD-së, e po ashtu edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7080/2022, datë 17.09.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci